



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit: 22.0.1-2010-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
PRISHTINËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010**

Prishtinë, Korrik 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje.....	5
II. Opinioni i auditimit	7
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	7
IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar	8
V. Pasqyrat financiare	9
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	9
V.2 Cilësia e informatave	10
VI. Realizimi i Buxhetit.....	11
VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)	11
VI.2 Shpenzimet.....	12
VI.3 Pasuritë dhe Borxhet.....	16
VII. Kontrolli mbi menaxhimin	17
VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	17
VII.2 Auditimi i Brendshëm.....	17
VIII. Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës.....	19
Shtojca I. Komentet e Prishtinës dhe përgjigjja e ZAP-it.....	20
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	24

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjencia për Prokurim Publik
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
KA	Komiteti i Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
LAB	Ligji për Auditimin e Brendshëm
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NP	Ndërmarrje Publike
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKA	Zyrtar Kryesor Administrativ

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (SNISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogarit e arkëtushme është jo i plotë dhe i pasaktë;

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtushme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme në Komunën e Prishtinës nuk është dizajnuar në mënyrë të duhur për eliminim e dobësive ekzistuese dhe ato nuk po implementohen si duhet. Kjo do të duhej të adresohet për të përmirësuar performancën e organizatës.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojnë:

- Se janë kryer analizat të rrënjësishme të të metave të MF/K
- Të marrë një sërë masash të cilat do të eliminonin të gjitha mangësitë e identifikuara;
- Të forcoj procedurat për kontroll të brendshme administrative si dhe të atyre operative;
- Revitalizimi i ndërgjegjshmërisë të stafit në lidhje me kërkesat e menaxhmentit financiar dhe kontrollës, për të bërë këtë procesi i prokurimit duhet të jetë prioritet; dhe
- Forcimi i regjimit të përgjithshëm për Auditimin e Brendshëm

Menaxhmentit të Prishtinës i është dhënë mundësia për të bërë komente në draftin e këtij raporti. Në këtë raport janë bërë më pas një numër ndryshimesh.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe entiteti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën 1.

Menaxhmenti është zotuar që do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr.16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë për Komunën e Prishtinës.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi kryer auditimin e ndërmjetëm të Komunës së Prishtinës. Gjatë asaj faze të auditimit, kemi adresuar faktin se si janë trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Po ashtu, kemi këshilluar menaxhmentin për adresimin e çështjeve në pasqyra financiare, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar pasqyrat vjetore financiare të Komunës në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Prishtinës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;

- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Komunë.

Në këtë raport, ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të komunës, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat kryesore financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë.

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se informacioni i shpalosur mbi pasuritë fikse dhe llogarit e arkëtushme është jo i plotë dhe i pasaktë;

Shpalosja jo e plotë e pasurive fikse dhe llogarive të arkëtushme nuk ndikon në opinionin mbi pasqyrat financiare të hartuara në pajtim me SNKSP për kontabilitetin në bazë të parasë së gatshme. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes*).

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin tonë të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të vitit 2009 janë dhënë 10 rekomandime kryesore. Prej këtyre rekomandimeve, dy janë adresuar plotësisht, dy pjesërisht, ndërsa gjashtë të tjera janë në proces të implementimit. Këto gjashtë rekomandime ndërliken me:

- Forcimin e masave të kontrollit të brendshëm në fushën e prokurimit duke respektuar plotësisht LPP;
- Formimin e një komisioni në kuadër të komunës për regjistrimin e plotë të pasurisë fikse;
- Regjistrimi i plotë i obligimeve financiare dhe detyrimeve kontingjente, si dhe raportimi i saktë i tyre në pasqyrat financiare;
- Regjistrimi i të gjitha të hyrave sipas kodeve përkatëse si dhe rishikimi i kontratave mbi pronën publike;
- Harmonizimi i të hyrave në mes drejtorive, financave dhe Thesarit me qëllim të evitimit të gabimeve eventuale; dhe
- Fuqizimi i auditimit të brendshëm si mjet parandalues i gabimeve;

Futja e të hyrave nga parku i Gërmisë në vitin 2010 në sistem si dhe të hyrat nga Auto tregu është inkujaruese.

Mos adresimi i rekomandimeve të mbetura paraqet një obligim të pa kryer nga menaxhmenti i komunës dhe një shqetësim për ZAP.

IV. Buxheti i Shpenzuar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Shpenzimeve në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve në euro (€)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar 2010	Buxheti i shpenzuar 2009
Grandi i Qeverisë – Buxheti	32,828,000	32,613,000	32,827,996	32,721,713	29,151,363
Të hyrat vetjake	32,412,000	31,440,000 ¹	31,439,924 ²	15,276,634	18,460,430
Donacionet e vendit		215,000	215,000	3,281	
Donacionet e jashtme		0	0		
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	65,240,000	64,268,000	64,482,920	48,001,629	47,611,793
Pagat dhe mëditje	16,898,000	16,898,000	16,897,992	16,534,008	15,132,076
Mallra dhe shërbime	6,014,000	5,991,000	5,991,521	5,154,749	5,100,108
Shpenzimet komunale	2,116,000	2,116,000	2,115,714	2,100,660	2,703,116
Subvencionet dhe transferet	1,046,000	1,046,000	1,046,142	1,035,950	578,052
Investimet Kapitale	39,166,000	38,217,000	38,431,551	23,176,262	24,098,441
Rezervat					
II. Gjithsej shpenzimet	65,240,000	64,268,000	64,482,920	48,001,629	47,611,793

Konkluzioni

Sipas të dhënave nga tabela më lartë, shihet se buxheti final për vitin 2010 për komunën e Prishtinës ka qenë 64,482,920€ Shpenzimet totale për vitin 2010 ishin 48,001,629€ apo rreth 75% e buxhetit final. Ne kemi vërejtur se në muajin dhjetor janë shpenzuar mesatarisht 35% për investime kapitale, 41% për subvencione dhe transfere, 23% për mallra dhe shërbime si dhe 9% për paga dhe mëditje. Për tre muajt e fundit, buxheti vjetor është shpenzuar rreth 48%.

¹ Të hyrat vetjake të planifikuara

² Të hyrat e pranuar në vitin 2010 ishin 31,439,924€ në këtë shumë janë të përfshira edhe të hyrat nga viti 2009 në vlerë prej 12,692,648€

Ne kemi vërejtur se komuna në fund të vitit kishte bërë pagesa të shumta për investime kapitale, janë disa arsye për këtë, përfshirë edhe kontestet ligjore. Megjithatë planifikimi për investime kapitale si dhe mënyrën se si janë realizuar gjatë vitit lënë vend për përmirësim. Këtu përveç të tjerash është mosrespektimi dhe veprimi jo në përputhje me ligjin për buxhetin.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Që shpenzimi i mjeteve të bëhet në harmoni me planin e rrjedhës së parasë.

V. Pasqyrat financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe Udhëzimit Administrativ 16/2010, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- Pasqyrat financiare nuk janë përgatitur plotësisht në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 16/2010 sepse llogaritë e arkëtueshme, të pagueshme dhe pasuritë nuk janë shpalosur të gjitha;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore me datën 31/01/2011 dhe janë dorëzuar në MEF;
- Pasqyrat Financiare janë përgatit në vetëm në gjuhën Shqipe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2010.

Konkluzioni

Mos përgatitja e plotë e pasqyrave financiare sipas kërkesave të UA ka pasur si rezultat shpalosje jo të drejtë dhe jo të saktë.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

Se me rastin e përgatitjes së pasqyrave financiare të përfillen të gjitha kërkesat që dalin nga UA, me qëllim që pasqyrat të prezantojnë drejtë pozitën financiare të komunës.

V.2 Cilësia e informatave

Pasqyrat Financiare të komunës të përgatitura më 31.01.2011 për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010 nuk kanë qenë në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.16/2010. Ato përmbanin keq deklarime dhe ishin të pasakta. Gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga Komuna që pasqyrat financiare të versionit fillestar të korrigjohen.

Pasqyrat financiare të komunës, pas kërkesës sonë janë korrigjuar dhe dërguar për herë të dytë në Thesar, Mirëpo, edhe PVF finale prapë përmbajnë gabime.

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po i raportojmë ato në pajtim me ISSAI 1260:

- Pasuritë fikse nuk janë shpalosur tëgjitha;
- Nuk janë shpalosur pagesat nga palët e treta dhe informatat shtesë për llogarit e pagueshme dhe të arkëtueshme; dhe
- Llogaritë e arkëtueshme nuk janë shpalosur në pasqyrat financiare.

Konkluzioni

Dobësitë ne raportimin e jashtëm financiar ende egzistojne. Komuna nuk ishte në gjendje të prodhoj shpalosje të PVF-ve që prezantojnë informata te mjaftueshme.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të :

- Analizoj arsyet se përse pasqyrat financiare përmbajnë gabime dhe pasaktësi;
- Organizojë dhe kontrollojë informatat e brendshme në atë mënyrë që nevojat e menaxhmentit si dhe forcimi i nevojave të informacioneve të jashtme të sigurohen mirë financiarisht; dhe
- Për personat përgjegjës që hartojnë pasqyrat financiare të organizoj trajnime shtesë.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2010 ishin 31,440,000€ ndërsa të hyrat e përgjithshme vetjake të pranuar ishin 31,439,924€ Prej tyre, të hyrat vetjake të bartura nga viti 2009 ishin 12,692,648€ ndërsa të hyrat e mbledhura për vitin 2010 ishin në shumë prej 18,747,276€

Gjetjet tona lidhur me testet e kryera nga të hyrat vetjake të komunës janë paraqitur më poshtë.

Mos barazim i të hyrave për lejet ndërtimore

Sipas raportit vjetor të Departamentit të Urbanizimit të hyrat nga lejet e ndërtimit janë shënuar në shumën prej 8,553,644€ Në librin kryesor dhe Departamentin e financave ishte regjistruar shuma prej 8,564,365€ Diferenca prej 10,721€ ishte e pa qartë për zyrtarin e të hyrave. Duke mos ditur të ofroj shpjegimet e duhura. Borxhi i pa arkëtuar në fund të vitit, sipas shënimeve të drejtorisë së Urbanizmit ishte 6,705,885€

Mungesa e regjistrave për llogaritë e arkëtueshme

Komuna përveç tatimit në pronë dhe lejeve të ndërtimit, nuk mbanë regjistra të ndara të llogarive të arëketueshme. Të hyrat tjera mbahen vetëm në baza të inkasimeve. Faturimet dhe borxhet e painkasuara nuk regjistrohen veçmas. Kjo e bën të pamundur që komuna të përgatisë raporte të sakta dhe të besueshme për të gjitha të hyrat vetjake.

Rënie e inkasimit për tatimin në pronë

Gjatë vitit 2010 në kuadër të hyrave nga tatimi në pronë, në llogari të komunës janë regjistruar 3,776,196€ që krahasuar me vitin 2009 shihet një rënie prej 6%. Kjo rënie sipas sqarimeve të komunës është si rezultat i formimit të komunës së re të Graçanicës. Program i ri i tatimit në pronë ende ka mbetur i pa kompletuar si rezultat i problemeve të cilat janë paraqitur në MEF. Ky program nuk ka arritur të jep informata dhe qasje zyrtarëve të komunës që të rishikoj dhe t'i monitoroj. Kishte raste kur një qytetar kishte bërë pagesën dhe nuk ishte shlyer borxhi i tij.

Gjatë testimit të pagesave për tatimin në pronë nga kategoria për afarizëm, kemi vërejtur se komuna nuk kishte ndërmarr veprime konkrete në inkasimin e borxheve të vjetra, ku borxhi ndaj komunës ishte 4,279,763€

Regjistrimi i të hyrat nga arsimi jo formal në kuadër të institucioneve parashkollore

Sipas rishikimit të raporteve financiare të Shkollës së mesme "28 Nëntori" kemi vërejtur se të hyrat nga arsimi jo formal dhe trajnimi për instruktor janë inkasuar 67,020€ Ne kemi vërejtur se këto të hyra nuk janë regjistruar në kuadër të kodit përkatës.

Konkluzion

Menaxhmenti i komunës nuk kishte ndërmarr masa të duhura në mënyrë që të inkasoj të hyrat vetjake të faturuara ndaj bizneseve. Kjo ka ndikuar që të hyrat e mbledhura të jenë më të ulta sesa ato të pritura. Regjistrimi i të hyrave në kodet jo përkatëse prodhon informata të pa sakta dhe si të tilla mund të mbivlerësojnë apo nënvlerësojnë të hyrat sipas kategorive.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Marrjen e masave për rritjen e inkasimit të të hyrave nga tatimi në pronë;
- Regjistrimin e të gjitha të hyrave vetjake sipas kodeve përkatëse; dhe
- Se barazimet e të hyrave në mes drejtorive, financave dhe Thesarit bëhen me qëllim të prezantimit të drejt të të hyrave.

VI.2 Shpenzimet

Shpenzimet për investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe subvencionet dhe transfere për vitin 2010 ishin 31,470,704€ prej këtyre shpenzimeve kemi testuar gjithsej vlerën prej 12,614,279€apo 40%.

2.1 Blerjet përmes prokurimet

Pagesat 70% derisa niveli i punimeve ishte 35%

Kontrata e nënshkruar më 01.09. 2010 për “Ndërtimin e shkollës fillore në Hajvali”, ishte në vlerë prej 848,743€ Testimi i pagesave në shumë prej 595,651€ka nxjerr në pah se pagesat janë bërë në bazë të rekomandimit të organit mbikëqyrës, duke iu referuar kushteve të kontratës. Me rastin e ekzaminimit fizik dhe në bazë të bisedës me përgjegjësin e këtij projekti, kemi mësuar se pagesat nuk përputhen me punimet e kryera nga operatori. Sipas mbikëqyrësit disa pagesa janë bërë në bazë të një amendament të kontratës për ndryshimin e kushteve të pagesave të nënshkruar nga komuna dhe operatori. Ky dokument deri në kohën e auditimit nuk na është ofruar si dëshmi. Gjithashtu, derisa ishim në auditim, kemi mësuar se ky projekt është paguar 70% nga vlera e kontratës, derisa punimet ishin të përfunduara rreth 35%. Pagesat e këtij projekti ishin bërë gjithashtu nga mjetet e dedikuara për projektet tjera si dhe zotimi i mjeteve për këtë projekt ishte bërë në shumë prej 105,875€

Është paguar shuma prej 846,712€ si paradhënie për operatorin ekonomik

Ne projektin “Ndërtimi i kolektorit atmosferik” në shumë prej 3,045,674€ është paguar operatori në vlerë prej 846,712€ për furnizime me material ndërtimi, e jo për punët që ndërliken me projektin në fjalë. Me datën 14.12.2010 kësaj kontrate i është shtuar një

amendament për ndryshimin e kushteve të pagesës në të cilin është paraparë që operatorit t'i paguhet shuma në emër të furnizimeve me material ndërtimor e jo për punët e kontraktuara.

Hyrja në kontrata pa zotime të mjaftueshme

Te projekti "Ndërtimi i rrugës Bill Clinton", komuna ka lidhur kontratë në vlerë prej 1,621,497€ derisa mjetet e zotuarra për këtë projekt ishin 600,000€ Një praktikë e tillë e lidhjes se kontratave pa fonde të mjaftueshme është ndjekur edhe në shtatë projektet tjera.

Vonesa në realizimin e projekteve

Plani dinamik i ndërtimeve gjatë vitit 2010, nuk është përfillur nga punë kryerësit. Një projekt i filluar në tetor të vitit 2009 për ndërtimin e fushës sportive në Kodrën e Diellit sipas kontratës ishte paraparë të përfundoj për 60 ditë, ndërsa është përfunduar pas 8 muajve, (korrik të vitit 2010).

Pagesa e projekteve përmes kodeve të ndryshme

Sipas rishikimit të pagesave për projekte kapitale, kemi vërejtur se komuna financimin e një projekti të filluar nuk e bënë nga mjetet e ndara për projektin përkatës, por duke bartur mjete nga një kod në kodin tjetër të projekteve të ndryshme.

Konkluzioni

Ne mund të konkludojmë që të gjitha procedurat ashtu si edhe kontrolli dhe auditimi i brendshëm kane nevojë të forcohen. Kjo është një qështje rreth tërë procesit nga planifikimi, inicimi e deri te pagesa e fundit. Në një nga rastet e prezantuara me lartë gjyqtari ka filluar hetimin (Ndërtimi i kolektorit atmosferik), për shkak të kësaj ne nuk kemi vazhduar me tutje.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Se janë kryer analiza nga forma dhe implementimi i procedurave te implementimit dhe që kontrolli i kryerjes se këtyre rasteve me herët ne këtë raport duhet te meret parasysh;
- Një udhëzim i mbrenshem i ri të adoptohet mbi analiza të tilla;
- Të organizohen aktivitete për rritje të vetëdijesimit për të gjithë stafin e përfshirë në procedurat e prokurimit lidhur me këtë udhëzues të ri;
- Që auditorit të brendshëm i është besuar detyra për të audituar proceset aktuale të prokurimit; dhe
- Që masat administrative të duhura janë ndërmarr sipas nevojës.

2.2 Blerjet tjera

Pagesa të dyfishta për ngrohoren e qytetit Termokos

Me rastin e rishikimit të faturave të paguara për ngrohje, kemi vërejtur se janë bërë pagesa të dyfishta për muajin nëntor të vitit 2010, për shkollat "Faik Konica", "Hasan Prishtina", "Ali Sokoli" dhe "Dardania". Gjithsej shumat e paguara ishin 13,215€

Mbi 3,000€ shpenzime mujore për ujë regjistruhen në emër të shkollës në Dardani

Sipas rishikimit të faturave të ujit kemi vërejtur se në emër të shkollës fillore në Dardani faturohen shpenzime të ujit në vlerë rreth 3,297€ Për çdo muaj faturat për ujë janë pothuajse në vlerën e njëjtë dhe krahasuar me shpenzimet e ujit në shkollat tjera ku shpenzimet mesatare janë 400€, shkolla në Dardani shpenzon dhe paguan shuma të larta të ujit. Sipas pohimeve të zyrtarëve të komunës, ky shpenzim i lartë i ujit është nga rrjedhja e pa kontrolluar e ujit. Me datën 01/01/2011, obligimi i papaguar ndaj ndërmarrjes publike "Prishtina" kishte vlerën prej 19,948€

Regjistrimi i shpenzimeve të mirëmbajtjes nuk është regjistruar në kodin përkatës

Pagesa në vlerë prej 16,205€ i ishte bërë Kompanisë publike "Pastrimi" për mirëmbajtjen e rrugëve të Prishtinës. Kjo pagesë nuk ishte postuar në kodin përkatës, por ishte përfshirë në kodin e shpenzimeve komunale. Regjistrimi i tillë i shpenzimeve i bënë shpenzimet totale për mirëmbajtje të rrugëve. Pagesa e bëra në kuadër të kontratës nuk mund të njihen.

Janë kryer pagesa nga vendimet gjyqësore

Gjatë vitit 2010 komuna në emër të vendimeve gjyqësore ka paguar shumën prej 513,883€ Kjo shumë e paguar nuk ishte shpalosur në pasqyrat financiare të vitit të kaluar si detyrim kontingjent.

Konkluzioni

Komuna ka bërë disa pagesa të dyfishta. Pagesat për shfrytëzimin e ujit janë të pa qarta, dhe është vërejtur mungese e veprimeve tentuese për të zgjedhur problemin..

Regjistrimi i shpenzimeve të kontraktuara për mirëmbajtjen e rrugëve në kodin gabuar ekonomik shpjen ne pasqyrim të saktë të shpenzimeve të mirëmbajtjes. Detyrimet kontingjente mund të paraqesin keqdeklarim në pasqyrat financiare.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Shtimi i kontrollit me rastin e pagesave në mënyrë që të mos përsëriten pagesa të dyfishta si dhe të ndërpriten pagesat e pa arsyeshme.
- Se të gjitha shpenzimet do të regjistrohen sipas kodeve përkatëse në bazë të përshkrimit të kodit; dhe
- Shpalosjen e të gjitha detyrimeve kontingjente në P/F.

2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Gjatë vitit 2010 shpenzimet për paga dhe mëditje ishin 16,534,008€ Gjatë auditimit kemi vërejtur se në kuadër të kategorisë për paga dhe mëditje nga viti 2010, janë përfshirë edhe mëditjet³ për delegatët e Asamblesë Komunale.

Konkluzioni

Përfshirja e mëditjeve për delegatë të Asamblesë komunale në kodin për paga dhe mëditje nuk prezanton shpenzimet për delegatë dhe komisione të caktuara sic kërkohet.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se për të gjitha pagesat që kanë të bëjnë me delegatë dhe komisione të Asamblesë të regjistrohen në kodin e duhur.

³ Me plan kontabël ekziston kodi i veçante për mëditje të delegatëve të kuvendit Komunal.

VI.3 Pasuritë dhe Borxhet

3.1 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Ende mungon regjistri i plotë i pasurive kapitale

Edhe në vitin 2010 komuna nuk ka arritur të formoj një komision mbi vlerësimin dhe regjistrimin e pasurisë kapitale. Luna Parku në Velani nuk është regjistruar si pasuri. Zyrtarët e komunës kanë pohuar se shfrytëzimi i Luna Parku bëhet në bazë të një kontrate e cila e obligon ndërmarrjen komunale "Hortikultura" për menaxhimin e saj. Inkasimi i të hyrave që bëhet nga Luna Parku nuk derdhet në llogari të komunës.

Konkluzioni

Mos formimi i një komisioni për regjistrimin e pasurive kapitale rrit rrezikun që pasuritë apo prona publike të keqpërdoret.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Regjistrimin e pronës, objekteve dhe pajisjeve, në mënyrë të duhur.

3.2 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 ishte 9,507,857€ Këto obligime janë bartur për pagesë në vitin fiskal 2011.

Nuk ka evidenca të duhura për pagesën e obligimeve të bartura nga viti 2009

Ne kemi rishikuar edhe pagesat e kryera në vitin 2010 për faturat e papaguara nga viti 2009. Komuna nuk ka mbajtur regjistra kontabël të cilët reflektojnë faturat e paguara gjatë vitit 2010 për borxhet të bartura nga vitet e kaluara.

Konkluzioni

Mungesa e evidencave detaje për faturat e papaguara rrit rrezikun që faturat të paguhen më shumë se një herë.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës të siguroj:

- Se departamenti i financave mban evidenca të plota dhe të sakta dhe bën regjistrimin e të gjitha faturave të paguara dhe të papaguara, në mënyrë që të shmanget mundësia e pagesës së dyfishte.

VII.Kontrolli mbi menaxhimin

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Dobësitë e identifikuara në kontrollin e brendshëm dhe implementimi i tyre në gjithë komunën që janë përshkruar më lartë tregojnë se kontrollet e përgjithshme janë të dobëta dhe nuk ofrojnë siguri se aktivitetet operative dhe menaxhimi financiar funksionojnë në pajtim me objektivat e vendosura.

Konkluzion

Në përgjithësi, ne konkludojmë se niveli i kontrollit financiar është joadekuat dhe duhet dukshëm të përmirësohet duke i adresuar rekomandimet tona që janë dhënë këtë vite dhe vitin e kaluar..

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se do të ndërmerren hapat e duhur në implementimin e rekomandimeve të dhëna nga ky auditim dhe auditimet e mëparshme; dhe
- Se sistemi i kontrollit të brendshëm do të rishikohet dhe të propozohet marrja e masave të duhura për t'u siguruar se kontrollet janë duke funksionuar ashtu siç kërkohet.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka përmbushur planin vjetor të auditimit

NJAB kishte përgatitur një plan vjetor për vitin 2010. Është miratuar nga komiteti i auditimit. Gjatë vitit 2010 NJAB kishte kryer vetëm auditimin e të hyrave në Drejtorinë e mjekësisë familjare për vitet 2008/2009, ndërsa për vitin 2010 nuk ka kryer asnjë auditim.

Në komunën e Prishtinës ekziston komiteti i auditimit. Ky komitet gjatë vitit 2010 ka mbajtur dy takime në të cilat takime ishte diskutuar për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB për drejtorinë e shëndetësisë.

Konkluzioni

NJAB nuk ka arritur t'i përmbush kërkesat e menaxhmentit për ofrimin e sigurisë së kontrollet e brendshme funksionojnë mirë në komunë.

Rekomandimi 11

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se:

- Regjimi i auditimit të brendshëm është forcuar tërësisht;
- NJAB do të angazhohet në përmbushjen e planit të auditimit në tërësi, ashtu siç është aprovuar nga Komitetit i auditimit; dhe
- NJAB do të identifikoj fushat me rrezik të lartë dhe të fokusoj aktivitetet e auditimit në pajtim me format e vitit aktual.

VIII.Një konkluzion i Përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës

Sistemi i Menaxhmentit Financiar dhe Kontrollit nuk është i formuar si duhet dhe implementimi i procedurave aktuale le vend për përmirësim. Konkluzionet e përgjithshme mbi menaxhmentin janë se kontrollet e përgjithshme dukshëm duhet të forcohen dhe të përmirësohen edhe më tutje. Përmirësimeve duhet kushtuar kujdes procedurave tek përpilimi i Pasqyrave financiare, regjistrimi i të hyrave dhe barazimi në baza të rregullta me evidencat e Thesarit, postimi i të hyrave dhe shpenzimeve nëpër kodet përkatëse, çertifikimi (rregullsia) i pagesave, prokurimet dhe forcimi i kontrolleve mbi pagesat për investime kapitale, mallra shërbime dhe mbi pasuritë.

Rekomandimi i Përgjithshëm

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj:

- Se janë kryer analizat të rrënjësishme të të metave të MF/K
- Të marrë një sërë masash të cilat do të eliminonin të gjitha mangësitë e identifikuara;
- Të forcoj procedurat për kontroll të brendshme administrative si dhe të atyre operative
- Revitalizimi i ndërgjegjshmërisë të stafit në lidhje me kërkesat e menaxhmentit financiar dhe kontrollës, për të bërë këtë procesi i prokurimit duhet të jetë prioritet; dhe
- Forcimi i regjimit të përgjithshëm për Auditimin e Brendshëm

Shtojca I. Komentet e Prishtinës dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmentit të Prishtinës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe subjekti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Kapitujt e raportit	Pajtohemi	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Komentet e Komunës së Prishtinës	Komentet e ZAP-it
VI.2 Shpenzimet					
2.1 Blerjet përmes prokurimit					
E gjetura:				<p>Është paguar shuma prej 846,712€ si paradhënie për operatori ekonomik</p> <p>Furnizimet që janë bërë janë të lidhura drejtpërdrejtë me implementimin e projektit dhe të njëjtat paraqesin më shumë se 80 % të vlerës së pozicioneve të ekzekutimit të punëve, prandaj në këtë kontekst në asnjë mënyrë nuk mund të trajtohen si paradhënie sepse është konstatimi i menaxherëve</p>	Këtë nuk jemi duke e komentuar pasi që është nën hetime të prokurorisë.

				<p>të projektit, në pajtim me amandamentin për kushtet e pagesës, si dëshmi për furnizimet e kryera sipas specifikimit të kontratës për gjithsej 5 pozicione të cilat pasi është zbritë shuma prej 20 % në emër të mos-kryerjes së punëve ka mbet në vlerë prej 846.712,80 €Pra, një mall i furnizuar për këtë kontratë dhe i vendosur në punishte, natyrisht nuk mund të konsiderohet si veprim që nuk ka ndodh sepse siq' e përmendëm paraqet mbi 80 % e vlerës complete të pozicioneve të caktuara.(Prova 1.amandamenti i kontratës, Prova 2. Konstatimi i organit mbikëqyrës).</p> <p>Përveç konstatimit mbi blerjen e mallit dhe vendosjen në punishte e i cili material nuk ka mundur përkohësisht të hyjë në punë për shkak të kushteve atmosferike</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>(sezona e dimrit), Autoriteti Kontraktues për siguri të plotë të veten, ka kërkuar nga Operatori Ekonomik dhe e ka marrë sigurimin e pagesës në vlerën e barabartë me shumën e faturës, pra 846,712.86 € me afat të vlefshmërisë deri me 21.04.2011. (Prova nr.3 sigurimi i pagesës).</p> <p>Në ndërkohë, OE ka punuar dhe tash ka arrit të përmbushë në masë të përafërt me vlerën e faturuar realizimin e kontratës. Nëse konstatojmë këtu se nga vlera e pozicioneve ka qenë e zbritur vlera prej 20 % atëherë mund të përfundojmë se tashmë veq është përmbushur kryerja e punëve në vlerën e paguar si dhe një sasi e mallit të furnizuar për këtë projekt e cila në ndërkohë është rritur, gjendet në punishte. Pra, duam të</p>	
--	--	--	--	---	--

				<p>përkujtojmë se në asnjë moment nuk kemi të bëjmë as me paradhënie dhe as me tejkalim të kushteve të kontratës dhe se AK për kundërvlerën e paguar ka pasur në disponim mallin e furnizuar dhe Garancionin e pagesës, që të dyja në vlerë të plotë, pra siguri të dyfishtë.</p>	
Konkluzioni:					

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinion i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opionioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opionionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.